

**STATUTI I SHOQËRISË**  
**"REAL STONE. AL" shpk**

Ne Tirane, sot me date 09.02.2023 une Z. Andis Neli, i biri i Nazmiut, lindur me 28.07.1979 ne Burrel, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar , i identifikaur me leternjoftimin me nr. Persoanl H90728064V, me date leshimi 12.05.2022, ne cilesine e "Ortakut Themelues" deklaroj se me vullnet te lire e te plote e te singerte, dhe insiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodit Civil ne fuqi, ne ligjin 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerine Tregtare" ligjin nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ne ate Doganor, Fiskal, Tatimor, e hartoj Statutin e Shoqerise "REAL STONE. AL" SH.P.K.

**KREU I**

**Neni 1**

**Krijimi**

Shoqëria "REAL STONE. AL" shpk, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria")

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "REAL STONE. AL" shpk , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Z. Andis Neli, i cili nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gezon kuoten e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

**Neni 3**

**Selia**

DURRES – Xhazotaj, ZK 2574, Nr. Pas 154/175 Kodi Unik 2574023104

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu

edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te ortakut te vetem te shoqerise.

#### Neni 4- Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Shfrytezim te mineraleve te grupit te ndertimit dhe metalor. Ushtrimi i aktivitetit te shfrytezimit mineralar per mineralin Traktolit,mermer, garnit, gelqeror- dekorativ.
- import – eksport te mineraleve te grupit te ndertimit dhe metalor, Traktolit,Mermer, Granit, te gurit gelqeror- dekorativ.
- Shfrytezim i burimeve natyrore te tokes dhe nentokes te burimeve natyrore, geometrike etjim objektesh, ura, prita, ujesjellesa, kanalizime, punime mbrojtje etj. Ndertime civile dhe ekonomike.
- Rikonstruksion godinash civile, ekonomike dhe veshje fasadash. Prodhim guresh dekorativ dhe inerte.
- Pastrim dhe gjelberim i hapësirave publike. Rehabilitim i objekteve pas shfrytezimit. Instalime elektrike dhe hidraulike.
- Ndertim dhe mirembajtje rruge dhe kanalizime. Materiale ndertimi, punime ndertimi, hoteleri, turizem.
- Ngritja dhe mbulimi i konstruksioneve te kulmeve. Punime dhe sherbime te tjera te specializuara ne ndertim.
- Suvatime dhe montime dyer, dritare, shkalle etj., si dhe kryerja e aktiviteteve te tjera te ngjashme me to.
- Punime dheu, sistemim tarracash te terreneve.
- Prodhim i elementeve te paranderur dhe armocementit.

#### Neni 5- Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore pa afat.

## KREU II KAPITALI

### Neni 6- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem" i shoqerise **Andis Neli**, dhe perbehet nga:

- 1 (një) PJESE/KUOTE me vlere te pergjithshme 100.000 (njëqinde mijë) leke qe zoterohen nga **Andis Neli** qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund te jete mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

### Neni 7- Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

### Neni 8 Kuotat

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- c) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.



Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.  
Personi që kalon pjesën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit sipas ligjit nr. 131/2015, " Per Qendren Kombëtare të Biznesit " Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.  
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.  
Transferimi i kuotave të të tretet kufizohet me miratim të asamblese se ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

## KREU II ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRESE

### Neni 9

#### Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.  
Ortaku i Vetem është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

*Ortaku i vetem i shoqërisë vendos për çështje si :*

- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- investime;
- vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretit ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### Neni 10 – Administrimi

Administrator te shoqerise eshte ortaku i vetem i shoqerise, me te dhenat si me poshte vijon:

- **Z. Andis Neli, shtetas shqiptar, i biri Nazmiut, lindur me 28.07.1979**, ne Burrel madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr. Personal: **H90728064V** me date leshimi 12.05.2022.

***Administratori mund te emerohet dhe shkarkohet me vendim te Oratkut te Vetem te Shoqerise.***

-Emerimi i administratorit behet per nje afat 5 vjecar.

### Neni 11 - Kompetencat

Administratori ka të drejtë të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- g) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm të shoqërisë edhe në rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## **Neni 12** **Pergjegjesite**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortakët që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale

me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratoret, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

### **Neni 13 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

### **Neni14 Balanci i shoqerise dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e ortakëve te shoqerise, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.



Mbledhja e ortakut te vetem te shoqerise vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### Neni 15 Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve te shoqerise. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar per gatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

### Neni 16

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise ne perpjestim me kontributet e tyre ne kapitalin themeltar.

### Neni 17

*Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :*

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem te shoqerise;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin nr. 131/2015, " Per Qendren Kombetare te Biznesit"
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tyre emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët e shoqerise.

Nëse ortaku i vetem i shoqerise nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas



prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 18**

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

#### **Neni 19**

##### **Të drejtat e detyrimet e likuiduesit**

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqëri kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

#### **Neni 20**

##### **Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje ligjin nr. 131/2015, " Per Qendren Kombetare te Biznesit".

#### **Neni 21**

##### **Bashkimi**

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e

përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

## **Neni 22** **Ndarja**

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të ortakut të vetem duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e tyre në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasoje:

- a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta
- b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas ligjit nr. 131/2015, " Per Qendren Kombetare te Biznesit pa kryerjen e likuidimit.

## **Neni 23** **Shndërrimi**

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.



**Neni 24**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 25**  
**Mosmarreveshjet**

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 26**  
**Dispozita përfundimtare**

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lire nga ortaku themelues.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË "REAL STONE. AL" SHPK**

**Z. ANDIS NELI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI



V2023053790103474928

DATE 11/02/2023  
NR REP 1303

*Majlinda E. Demollari*  
*Talava e Përllogarit*  
*U. Paqumë*

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 11.02.2023 (dymije e njeset e tre), para meje Notere MAJLINDA DEMOLLARI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR.5, RR. VASO PASHA, GODINA NR. 1, APARTAMENTI NR.3, HYRJA NR .10, u paraqit personalisht:

DEKLARUES:

**Andis Neli**, atësia Nazmi, amësia Servete, shtetas Shqiptar, lindur në Burrel, Mat dhe banues në Tiranë, lindur më 28/07/1979, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038270194 dhe nr. personal H90728064V.

Subjekti i mësipërm, **Andis Neli** ne cilesine e Ortakut Themelues te Shoqerise "**REAL STONE.AL**" shpk në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, "Statutin e Shoqerise REAL STONE.AL shpk, date 09.02.2023, dhe une noterja vertetoj nenshkrimin e tij sipasligjit.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpujoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MAJLINDA DEMOLLARI

NOTERE  
*Majlinda E. Demollari*  
NIP: K41606040A  
Tel: 0682061560